

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Shpenzime për fiskalizimin për faturat”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime fiskale

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,932.677 (gjashte milion e nentëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës sipas 3 konkretisht në vlerën 138, 653,54 (njëqind e tridhjetë e tete mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e kater) lekë.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$6,932.677 \times 30\% = 2.079.803,1$$

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit, (2020, 2021,2022) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e 2020,2021, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006"Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 1,368,535.4 (një milion e treqind e gjashtedhjetë e tete mijë e peseqind e tridhjetë e pese pesëqind e katër) lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlloritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$6,932.677 \times 20\% = 1,368,535.4$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 e vlefshme, (**ose ekuivalente**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

- b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 20000 mbi “Sistemet e menaxhimit të informacionit”, e vlefshme (**ose ekuivalente**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 20000 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë të shërbimeve që kërkojnë dhe lidhen me mirëmbajtjen e sistemeve. Ky lloj certifikimi garanton AK se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi.

2.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) 1 punonjës të çertifikuar për mirëmbajtje rrjetesh.
- b) 1 punonjës të çertifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni ëeb.
- c) 1 punonjës të çertifikuar për sisteme cloud.
- d) 1 punonjës të çertifikuar për baza të dhënash.

Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë muajin e fundit.

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kontratën e punës
- b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- c) Listëpagesën e muajit të fundit.

Shënim: Për piket 2.5 operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Punonjësi për mirëmbajtje rrjetesh është i nevojshëm për testimet dhe support për probleme që lidhen me zgjidhjen e ofruar. Në mënyrë të veçantë këto shërbime do të kërkohen për lidhjen e sistemeve të UKT-së me sistemin e fiskalizimit.
- b. Punonjësi i çertifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni nevojitet për zhvillimin e sistemit. Operatori duhet të jetë në gjendje të përshtasë programin e fiskalizimit në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga UKT.
- c. Punonjësi i çertifikuar për sisteme në cloud është njohës i mirë i suportit të këtyre sistemeve. Meqë sistemi i kërkuar duhet të jetë hosted, OE duhet të disponojë personel me njohuri në këtë fushë.

d.Punonjësi i certifikuar për bazë të dhënash i cili nevojitet për ngritjen, ndërlidhjen dhe mirëmbajtjen e bazës të dhënave financiare që përmban sistemi.Duke qënë se faturat e e UKT sh.a janë të një volumi të rëndësishëm dhe cikli i përpunimit (raportimit të tyre në organet tatimore) është sa më e ulët, OE duhet të demonstrojë që ka personel të nevojshëm për mirëmbajtjen dhe support të bazave të të dhënave.

2.6 Oparatori ekonomik duhet te jete i certifikuar si prodhues sistemi software nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve ose distributor i autorizuar nga prodhuesi, si dhe per mirembajtjen e zgjidhjes softwar-ike per fiskalizimin, te veprimeve:

- Me dhe pa para në dorë;
- Pa para në dorë E-invoice;
- Faturë shoqëruese;
- Për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike
- Certifikimin e kompanise per cloud mbi te cilen operon zgjedhja e ofertuar;
- Certifikimin e kompanise per sistemeve te raportimit BI; qe ofrohet ne zgjedhjen e ofertuar;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar ne kriteret per kualifikim, vërteton se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e duhura për kryerjen e shërbimit të kërkuar dhe me cilësinë e kërkuar,gjithashtu këto kërkesa janë në përputhje me objektin e prokurimit, me rëndësinë e tij në mbarëvajtjen e punës së AK, por mbi të gjitha bazuar në legjislacionin përkatës. Konkretisht bazuar në VKM-në Nr.239, datë 20.03.2020 “Për kërkesa teknike dhe funksionale të zgjidhjes softëar-ike për procedurën e faturimit dhe fiskalizimit si dhe procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve softwar-ike” i ndryshuar.

Gjithashtu Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve më datë 24.04.2020 kanë hartuar një “Rregullore të përbashkët për saktësimin e Procedurave për Certifikimin dhe Rregjistrimin e Prodhuesve dhe Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Softëar-ike”. Ne Procedurave për Certifikimin dhe Rregjistrimin e Prodhuesve dhe Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Softëar-ike”. Në pikën 13 të kësaj rregulloreje citohet:

13. Certifikata e regjistrimit ne rregjistrin e prodhuesve ose mirëmbajtësve softwar-ike lëshohet nga AKSHI dhe DPT të cilët bashkërisht kanë të gjitha të drejtat mbi të.Certifikata lëshohet nëpërmjet portalit e-Albania. Certifikata do të përmbajë edhe kodin e prodhuesit/mirëmbajtësit së software-it dhe kodin e zgjidhjes së software-it të regjistruar. Formatit I miratuar I certifikatës do të jetë ai sipas modelit të aneksit 1, bashkëngjitur kësaj rregulloreje” .

Autorizimi i prodhuesit është ose distributori i autorizuar nga prodhuesi një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në kete prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht.

Certifikimet e per mirembajtje cloud si dhe sisteme BI, eshte ne perputhje me specifikimet teknike qe sistemi te instalohet ne nje ambient Cloud. Per kete kerkohet qe ofertuesi te kete njohuri minimale te verifikuara nga prodhuesi i ambientit cloud per administrimin. Ne menyre te vecanta duke pasur parasysh kerkesat qe lidhen me shpejtesine dhe performance e sistemit certfikimi do te garantoje UKT qe sistemi te jene operacional. Certifikimi per fiskalizimin kate bej me njohjen e prodhuesit me kerkesat e ligjit, por jo me performance apo shpejtesine e

operacioneve. Per kete certifikim cloud eshte i domosdoshem qe sistemi te perballoje numrin e madh te faturave (qe eshte vecanti I UKT).

Kerkesa qe OE eshte i certifikuar per zgjidhje BI te ofertuara, ka lidhje me specifikimet teknike qe sistemi i fiskalizimit te jete ne nje database te sigurte dhe te kete mundesi te perpunohet me shpejtesi dhe ne menyre te pamvarur nga UKT. Kjo kerkohet duke pasur parasysh numrin e madh te faturave dhe vecantit e UKT e perpunimin e tyre. Per kete zgjidhje te kerkuar kerkohet qe operatori te jete i certifikuar nga prodhuesi per te garantuar perpunim te sakte si dhe dhe siguri te veprimeve. Cdo nderhyrje, shtim raporti qe do te kryhet

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike (pjesë e DST-së) janë përcaktuar edhe arsyet e vendosjes të specifikimeve teknike.

Njësia e Prokurimit